



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

KOMUNA E PRISHTINËS
KRYETARI I KOMUNËS

Nr. 01-038-266383

Dat. 27-10-2016 2016

Në bazë të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/15, qershor 2008), dhe të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-110-391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës, sipas detyrës zyrtare nxjerr këtë

V E N D I M

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE QË KANË TË BËJNË ME PËRZGJEDHJEN E BIZNESEVE, TË CILAT DO TE JENË PJËSMARRËSE NË TREGUN E FUNDVITIT

I

Formohet komisioni për shqyrtimin e kërkesave për përzgjedhjen e bizneseve për treg të fundvitit.

II

Komisioni i cekur në pikën I të këtij vendimi, është në këtë përbërje:

1. Diellza Kelmendi, kryesuese,
2. Edona Bislimi, anëtare,
3. Sabri Gashi, anëtar,
4. Mevlude Zejnullahu, anëtare,
5. Drita Rudi, anëtare.

III

Detyra e komisionit është shqyrtimi i kërkesave që kanë të bëjnë me përzgjedhjen e bizneseve, të cilat do të jenë pjesëmarrëse në tregun e fundvitit.

IV

Për punën e kryer komisioni do t'i raportojë Kryetarit të Komunës.

V

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

U dorëzohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Qendrës për shërbim me qytetarë,
- Në dosje.

